



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 01.09.2026

MBLEDHJA Nr. 40,
Datë 03.09.2026, ora 14:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 59/2026, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 03.09.2026, ora 14:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 40 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të bordit të ERE-s nr. 35, dt. 10.08.2026; nr. 36, dt. 18.08.2026; nr. 37, dt. 20.08.2026; nr. 38, dt. 24.08.2026; nr. 39, dt. 28.08.2026.
2. Mbi miratimin e disa ndryshimeve në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e Gazit Natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-S nr. 97, datë 04.07.2017.
3. Mbi miratimin e licencave TIP për operimin në impiantet e GNL-së/GNK-së me përmasa të vogla”.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (sh.a. KESH)” sh.a. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga TEC-et Lundruese “Tigri 1”, me kapacitet të instaluar 50 MW dhe “Tigri 3”, me kapacitet të instaluar 60 MW.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREENSOL” sh.p.k. për përfshirjen e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës së prodhimit të energjisë elektrike.
6. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 223, datë 10.08.2026, “Mbi licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”
7. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 68, datë 08.04.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “RENEW” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW”, i ndryshuar.
8. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI